



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 qershor 2013
Nr. ref.: RK425/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rastin Nr. KI23/13

Parashtrues

Melihate Hakiqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A nr. 1197/2012 të 27
dhjetorit 2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës,**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është znj. Melihate Hakiqi, nga fshati Llapashticë e Epërme, komuna e Podujevës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është Aktgjykimi A. nr. 1197/2012 i 27 dhjetorit 2012 i Gjykatës Supreme të Kosovës, të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka potencuar se kur e ka pranuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar më 27 shkurt 2013, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit A. nr. 1197/2012 të 27 dhjetorit 2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilin Gjykata Supreme kishte refuzuar padinë e parashtrueses për vlerësimin e ligjshmërisë të Aktvendimit Nr. 5081032 të 7 shtatorit 2012 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS), në procedurën e konfliktit administrativ.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta); neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 29 i Rregullores.

Procedura në Gjykatë

5. Më 27 shkurt 2013, Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e znj. Melihate Hakiqi dhe e regjistroi atë në regjistrin përkatës të Gjykatës, me Nr. KI23/13.
6. Më 28 shkurt 2013, me Vendimin G.J.R. KI23/13 Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani (anëtarë).
7. Më 21 mars 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës dhe parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
8. Më 15 maj 2013, me Vendimin e Kryetarit për zëvendësimin e anëtarit të Kolegjit Shqyrtues, Gjyqtarja Snezhana Botusharova caktohet kryesuese e Kolegjit Shqyrtues.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 20 korrik 2006, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, kishte nxjerrë vendimin me nr. të dosjes 5081032, me të cilin, në bazë të kërkesës së

19 korrikut 2005, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, kishte miratuar kërkesën e parashtruesit lidhur me pension për persona me aftësi të kufizuar.

10. Ndaj këtij vendimi, në aftin ligjor, nuk kishte ndonjë ankesë të parashtruar nga ndonjë palë.
11. Më 21 maj 2012, Komisioni mjekësor për rishqyrtime i MPMS-së, kishte nxjerrë vendimin që mbante të njëjtin nr. të dosjes 5081032, e që i dedikohej znj. Melihate Hakiqi, me ç'rast i është REFUZUAR e drejta për pension të personave me aftësi të kufizuar.
12. Më 7 shtator 2012, Këshilli i ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuar i MPMS-së, nxori aktvendimin me nr. të dosjes 5081032, me të cilin refuzoi ankesën e parashtruesit dhe njëkohësisht konstatoi se vendimi i shkallës së parë ishte "plotësisht i bazuar konform Ligjit nr. 2003/23".
13. Në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhej se komisioni mjekësor i shkallës së parë ka konstatuar drejt dhe të plotë gjendjen faktike, me faktin se kandidati nuk i përmbush kriteret e nenit 3 të Ligjit Nr. 2003/23, dhe faktin se komisioni i shkallës së dytë, i përbërë nga ekspertët mjekësorë të fushave përkatëse, ka analizuar komplet dokumentacionin shëndetësor të parashtruesit dhe ka konstatuar gjendjen e njëjtë si në dispozitivin e vendimit të shkallës së parë.
14. Kundër këtij aktvendimi, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padi në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë së tij.
15. Më 27 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas padisë së parashtruesit të kërkesës në procedurën e konfliktit administrativ, ka nxjerrë Aktgjykimin A. nr. 1197/2012, me të cilin e ka REFUZUAR padinë e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.
16. Në arsyetimin e aktgjykimit të vet, Gjykata Supreme ka theksuar se pala e paditur ka aplikuar drejt të drejtën materiale, kur ka konstatuar se paditësja nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me nenin 3 të Ligjit për PPAK dhe, gjithashtu, edhe komisionet mjekësore, të përbëra nga ekspertë mjekësorë të fushave përkatëse, pa mëdyshje e kanë vërtetuar drejt gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës, andaj Gjykata Supreme, nga thëniet në padi, nuk gjen prova se do të duhej të vendosej ndryshe, apo se vendimet e MPMS-së janë të kundërligjshme.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës ka pohuar se komisionet mjekësore të MPMS ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore "të drejtën për pension për personat me aftësi të kufizuar", edhe pse i ka plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës, duke refuzuar padinë e parashtruesit në procedurën e konfliktit administrativ, gjithashtu ka bërë të njëjtën shkelje.
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me aktgjykimin e kontestuar, i janë shkelur këto të drejta të njeriut, të mbrojtura me Kushtetutë:

- a) Neni 23 (Dinjiteti i Njeriut)
- b) Neni 24 (Barazia para Ligjit)
- c) Neni 25 (E Drejta për Jetën)

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë.
20. Për këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
21. Gjithashtu, Gjykata merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) kërkesa është qartazi e bazuar”.*
22. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, që pretendohet se janë shkelur, Gjykata konstaton: nenin 51 të Kushtetutës [Mbrotja Shëndetësore dhe Sociale], paragrafi 2, është paraparë qartazi:

“Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj”.
23. Nga përkufizimi juridik i nenit 51 të Kushtetutës, shihet qartë se sigurimi social për “aftësi të kufizuar, papunësi dhe moshë të shtyrë” rregullohet me ligj, në rastin konkret çështja e pensionit të personit me aftësi të kufizuar është rregulluar me Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, Nr. 2003/23, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 6 nëntor 2003.
24. Procedurat e aplikimit dhe të plotësimit të kushteve për gëzimin e kësaj të drejte janë të parapara me këtë ligj, sikur edhe e drejta e apelimit të vendimeve kur palët nuk janë të kënaqura me vendimet që kanë të bëjnë me kërkesën e tyre.
25. Komisionet administrative të MPMS-së, duke nxjerrë vendimin e 21 majit 2012 dhe aktvendimin e 7 shtator 2012, kishin vepruar pikërisht në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Për më tepër, Gjykata Supreme, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre në procedurën e konfliktit administrativ me aktgjykimin e saj përfundimtar, A. nr. 1197/2012, të 27 dhjetorit 2012, i kishte cilësuar si tërësisht ligjore dhe të bazuara.

26. Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 23 (Dinjiteti i Njeriut); të nenit 24 (Barazia para Ligjit); dhe të nenit 25 (E Drejta për Jetën) të Kushtetutës, konstatoi se parashtruesi nuk ka paraqitur fakte, para kësaj gjykate, që do të vërtetonin pretendimin e parashtruesit, sepse, në fakt, pos konstatimit se parashtruesi i ka plotësuar kushtet për pension, nuk ka ofruar dëshmi që do të vërtetonin shkeljet e pretenduara dhe as dëshmi se nga cilat organe gjyqësore apo administrative është trajtuar si i pabarabartë.

27. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe, me këtë rast, dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, e në këtë rast edhe i organeve administrative, dhe se roli i saj është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë, prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (*Shih, mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D., 1996-IV, paragrafi 65*).

28. Gjykata Kushtetuese ka rol subsidiar krahasuar me sistemet e rregullta gjyqësore apo edhe administrative vendëse dhe është e dëshirueshme që gjykatat vendëse ose organet kompetente administrative me kompetenca të vendimmarrjes efektive të kenë fillimisht mundësi të vendosin për çështje të pajtueshmërisë të së drejtës së brendshme me Kushtetutën (*Shih vendimin e GJEDNJ-së, A, B dhe C, kundër Irlandës [DHM], § 142*).

29. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t’u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, Meztur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005*).

30. Gjykata Kushtetuese kishte vepruar njëjtë, në kushte dhe në rrethana të njëjta, edhe në Rastin KI101/11, kur kishte nxjerrë Aktvendimin për papranueshmëri, duke e refuzuar kërkesën e parashtruar para saj si qartazi të pabazuar.

31. Në këto rrethana, parashtruesi i kërkesës “nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”, andaj, i propozoj Kolegjit shqyrtues që, në përputhje me rregullin 36, paragrafi 2, pikat c dhe d, ta refuzojë kërkesën si qartazi të pabazuar, dhe

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.2 pika (c) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 qershor 2013, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani